

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali me kompanitë si KAYO-s/ Bozdo: Është shpikur për të mbajtur jashtë kontrollit të gjithë financi met publike
ADRESA	https://piranjat.al/politike/skandali-me-kompanite-si-kayo-s-bozdo-shte-shpikur-per-te-m-bajtur-jasht-i103638
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 11:19:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 11:15:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d89f1d69c2df9aa2764c0c2bf2f7ea9772ffd20e51e4216a43e89e62f3796ef5
TEKSTI	65025f63baf16e56db26420f80396963e2cd618ebfb08c028ad8441ae8e410d1
PAMJA	aa0992b1ad0dd188894acdf033e8fcaa5e381c36aad3412624e9354c73fd8491

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	65cd8415ade5f6c2b9cea9a2c5d93387fcc1ab1e84a6fbda42dae7cc3e16e1cf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	edfed3cd86f7048b6622657648b993749a8a23a92bfae9d609e7fe0135b574af
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/65cd8415ade5f6c2b9cea9a2c5d93387fcc1ab1e84a6fbda42dae7cc3e16e1cf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [per te mbajtur jashtë](#) ■ [jashtë kontrollit të gjithë](#) ■ [projekti i gj për VNM- në Ina](#) ■ [Diasporën, deputetja e PD-së Ina](#) ■ [politikes italiane dhe](#) ■ [figurat më të shquara](#) ■ [reagon për herë të parë](#) ■ [mbledhjes së qeverisë lidhur me shqiptarët](#) ■ [Gjykata e Shkodrës](#) ■ [Andri Vulaj, autor i](#)

[POLITIKE](#)

Skandali me kompanitë si KAYO-s/ Bozdo: Është shpikur për të mbajtur jashtë kontrollit të gjithë financimet publike

Piranjat Përditësimi i fundit 11 Shtator 2026, 13:15



'Këto janë sisteme të veçanta të shpikura për të mbajtur jashtë kontrollit të gjithë financimet publike, që askush të mos ketë asnjë të dhënë se çfarë bëhet.' Kështu e ka cilësuar deputeti i Partisë Demokratike, Eno Bozdo, modelin e kompanive publike dhe marrëdhënieve të tyre me privatët, duke denoncuar një skemë që, sipas tij, po i dorëzon privatit të drejtat monopolistike të shtetit dhe po mbyll çdo derë të transparencës.

Bozdo ka kërkuar publikisht moratorium për kompanitë publike dhe garë ndërkombëtare për çdo ortak privat, duke argumentuar se nuk mund të ketë kontroll real mbi fondet publike kur kompanitë krijohen me kapital shtetëror, marrin ekskluzivitetet dhe më pas kalojnë nën kontroll privat pa garë dhe pa transparencë.

Sipas deputetit demokrat, modeli i KAYO-s është shembulli më flagrant i kësaj skeme. Ai e ka përshkruar KAYO-n si një 'guaskë ligjore', e cila është përcaktuar si furnizuese e vetme dhe është përjashtuar nga prokurimi konkurrues, ndërsa më pas ka krijuar kompani me ortakë privatë.

Pikërisht në këtë klimë, ku opozita akuzon qeverinë për përdorim të institucioneve dhe mekanizmave shtetërorë për të favorizuar interesat e caktuara private dhe politike, Partia Demokratike ngre shqetësimin edhe për një tjetër front: goditjen e kundërshtarëve politikë përpara zgjedhjeve lokale të vitit 2027.

Fjala e plotë e deputetit të PD, Eno Bozdo:

Në 6 vitet e fundit, kemi një rritje shumë të madhe, të paprecedentë të numrit të shoqërive publike në Shqipëri me pronësi vendore ose qendrore, një pritje kjo e nxitur qëllimisht nga qeveria shqiptare, e cila duke themeluar këto shoqëri në sektorë të ndryshëm të jetës ekonomike të vendit, po rrit gjithmonë e më shumë praninë e sektorit publik në ekonomi.

Për më tepër shumë nga këto kompani kanë marrë të drejta ekskluzive monopolistike, duke dëmtuar tregun, transparencën dhe konkurrencën në treg.

Më tej sipas një skenari të mirë menduar, pa zhmë, këto kompani monopolistike, u jepen nën kontroll privatëve, miq të partisë dhe kryeministrit të cilët operojnë në guaskën e kompanisë publike, por nga ana tjetër duke ju shmangur ligjeve të prokurimit, të transparencës, të drejtës për të kërkuar informacion dhe marrë informacion nga publiku dhe palët e interesuara, por dhe atyre të auditimit publik nga institucionet përgjegjëse.

Praktikisht ajo që ne dëshmojmë çdo ditë është një skemë e mirëpërgatitur, e cila ka pasur gjithmonë qëllim që të krijojë të drejta tregtare monopolistike, e cila më pas të cedojë, t'i kalojë, transferojë ato të privati.

Rasti KAYO dhe skenari i shëndetësisë janë provat e pamohueshme të këtij fenomeni.

Siç e shikoni, këtu kemi paraqitur një listë të të gjitha kompanive publike të krijuara në Shqipëri nga pushteti qendror, duke filluar nga viti 2019 më të famshmen, Korporata e Investimeve Shqiptare që menaxhon çdo pronë publike, deri në vitin 2026.

Kjo është lista e plotë dhe po të shikoni janë më shumë se 20 kompani të krijuara me kapital publik. Në total janë 76 edhe me ato të krijuara më parë, dhe kemi edhe 3 kompani të tjera që janë në proces krijimi.

Është shoqëria shtetërore e pyjeve, shoqëria e barnave dhe pajisjeve mjekësore. Praktikisht një KAYO bis që do të operojë me të gjitha fondet publike të shëndetësisë dhe operatori i shoqërive shtetërore.

Po të shikoni këto kompani kanë kapur të gjitha sektorët ekonomikë të vendit.

Armatimi, tarifimi rrugor, zhvillimi, pulla fiskale, sterilizimi spitalor, teknologji dixhitale, transporti publik-privat, mbetje dhe pyje.

Faktet na tregojnë se shteti krijon shoqëri të reja publike ku më parë nuk operonte, në sektorët e armatimit, zhvillimi, shëndetësi, pyje, transport.

Shtetit më pas u jep monopol furnizuesit të vetëm, pastaj e përjashton nga prokurimi konkurrues me vendim të Këshillit të Ministrave, kompani të cilat pastaj fillojnë dhe kontrollohen nga privati. Dhe më pas, siç thashë, vjen çasti i kontrollit nga privati me kontratë të negociuar pa garë, pa çmim të përcaktuar e të tjerë e të tjerë.

Rezultati i kësaj strategjie është shumë i qartë: nuk është fuqizimi i shtetit në ekonomi, përkundrazi, është dorëzimi të privati i të drejtave monopolistike të vetë shtetit. Kjo ndodh tani.

Përpara se të hyjmë në thellësi, një referencë ndaj atyre që qeveria i pëlqen shpesh t'i citojë: çfarë kërkon Bashkimi Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar? Bashkimi Evropian kërkon mbikëqyrje dhe qeverisje të forcuar të ndërmarrjeve shtetërore, prokurim konkurrues, kontrollin e ndihmës shtetërore. Çfarë ndodh në të vërtetë në Shqipëri? Krijohen shoqëri të reja pa politike pronësie, monopolizohet furnizimi me vendime të Këshillit të Ministrave, asnjë njoftim për ndihmën shtetërore dhe për klasterin e ndërmarrjeve të reja.

Çfarë kërkon FMN? FMN kërkon menaxhim të rrezikut fiskal nga ndërmarrjet shtetërore dhe koncesionet, pastrim të detyrimeve të prapambetura, transparencë fiskale. Në anën tjetër, këtu krijohet Banka e Zhvillimit me 10 miliardë lekë nga Ministria e Financave, e cila është në të njëjtën kohë edhe pronare, edhe rregullatore, edhe mbikëqyrëse.

E çfarë thotë e famshmja marrëveshje e Stabilizim-Asociimit në nenin 40-71? Ndërmarrjet publike dhe ato me të drejta ekskluzive të mos dëmtojnë konkurrencën, monopolet tregtare të mos jenë pa diskriminim. Furnizuesi i vetëm i caktuar me vendim, siguri fizike falas nga Forcat e Armatosura për shoqëri me shumicë private. Kjo ndodh te shoqëritë me shumicë private.

Ja dhe çfarë do të thonë standardet e OECD-së. Sa për sqarim, Bashkimi Evropian nuk ka direktivë të përcaktuar të dedikuar për qeverisjen e korporatave publike, por i referohet gjithmonë udhëzuesit për qeverisjen e mirë të korporatave publike të OECD-së. Nuk jam duke i lexuar të gjitha, por dy pikat e fundit shikoni: ndarja e pronësisë së pronësi dhe rregullimi. Është një ndër kushtet thelbësore. Shteti është njëkohësisht rregullator dhe operator.

Prezantimi_Shoqerite_Publike_2026 (2)Download

Rasti i fundit është shoqëria e re e cila u krijua së fundmi. Neutraliteti konkurrues, kjo është bibla e qeverisjes, konsiderohet bibla e qeverisjes në korporatat publike, te pronësitë shtetërore publike pra.

Neutraliteti konkurrues: siguri fizike falas nga Forcat e Armatosura, akses pa garë në pasuritë publike. Ky është rasti tipik i KAYO-s. Kemi pak te KAYO.

Siç thashë në thelb, siç bëhet e qartë edhe nga audiopërgjimet, siç bëhet e qartë edhe nga investiguesit, KAYO në fakt nuk është një ndërmarrje, nuk është prodhues, në fakt është vetëm një guaskë ligjore. Është themeluar në vitin 2024. Me VKM në vitin 2025 përcaktohet si furnizues i vetëm dhe përjashtohet pastaj nga prokurimi konkurrues. Realiteti është që KAYO nuk prodhon asgjë. Zero veprimtari në bilanciç e viteve 2024-2025. E vetmja veprimtari e saj që nga regjistrimi është krijimi i katër shoqërive me privat. Në periudhën gusht-nëntor 2025.

Dhe këtu dua të citoj pastaj një direktivë shumë të rëndësishme të Bashkimit Evropian... përjashtimi nga prokurimi nuk vlen kur shoqëria kontrollohet nga privati. Por kjo është skemë që i ofron privatit guaskën mbrojtëse të pronësisë publike të KAYO-s, e cila është boshe vetë.

Katër kompanitë, siç do ta shohim dhe më poshtë, në thelb janë private. Dhe nuk janë katër, por siç e shikoni, TIMAK Defense, Advanced Armed Tech, MKD-ja dhe Guna Tactical, janë katër shoqëri, por janë me dy grupe pronarësh. TIMAK dhe Unot 18 kanë të njëjtin ortak. Kapital thelbësor rreth 35 mijë euro për këtë shoqëri, asnjë ortak nuk ka kapacitete prodhuese apo kapital të rëndësishëm, thelbësor. Asnjë procedurë konkurruese e dokumentuar për përzgjedhjen e ortakëve privatë. Sepse praktikisht ligji i sektorit shqiptar gjithashtu do të kërkonte që në qoftë se do të ndërtoheshin nënkompani, bija të veçanta, atëherë duhet të kishin një proces konkurrimi.

Pse asnjë institucion nuk i kontrollon dot? Sepse të tre ligjet që janë thelbësore për kontrollin e fondeve publike (ligji për prokurimin publik, ligji për veprimtarinë e KLSH-së, auditit i brendshëm) nuk arrijnë dot të operojnë kur shumicën e bordit dhe pronësinë reale e ka privati.

E thënë thjesht, këto shoqëri blejnë ku të duan, me çmimin që vendosin ato vetë dhe ia shesin shtetit pa tender, pa auditim dhe pa llogaridhënie. E askush nuk kupton dot asgjë ku përfundojnë paratë.

Sa para kalojnë nëpërmjet kësaj skeme? Buxheti për mbrojtjen i vitit 2026, me ndryshimet e fundit, është diçka më shumë se 70 milionë euro. 80% e fitimeve shkon në duart e privatit. Këto blerje kalojnë përmes katër shoqërive të cilat përcaktojnë vetë çmimin e blerjes dhe atë të shitjes ndaj shtetit.

Fitimi ndahet sipas pronësisë, 80% te privati në tre shoqëri dhe vetëm në një shoqëri është 50% te privati. Po kush është triku tjetër që ka përdorur qeveria për t'i nxjerrë këto kompani jashtë interesit publik? Kjo ka ardhur me 10 prill të vitit 2026 kur me VKM janë rritur pragjet e klasifikimit si shoqëri me rëndësi për interesin publik.

Ligji detyron shoqëritë me rëndësi për interesin publik t'i nënshtrohen auditimit ligjor. Pragu i qarkullimit është rritur nga 2.5 miliardë lekë në 4 miliardë lekë (rreth 40 milionë euro) dhe aktivet i ka rritur nga 1.25 miliardë në 2 miliardë lekë (rreth 20 milionë euro).

Pragjet janë rritur, shoqëritë që bien nën këtë prag nuk auditohen më nga asnjë ligjor. Mbyllet çdo derë për të bërë transparencë ndaj këtyre kompanive.

Tani kemi një rast dhe më interesant, marrëveshja e 12 majit të këtij viti të shitjes së aksioneve midis KAYO dhe shoqërisë Guna Tactical. Janë shitur 2% të aksioneve me këtë marrëveshje. Dhe shteti kalon nga kontrolli i tij prej 51% në 49%, pa zhurmë, pa u ndërë. Kjo kontratë ka plot të meta që nuk janë të meta rastësore, janë për me qëllim, për të favorizuar pozicionin e privatit. Pronësia kalon përpara se të dihet çmimi, nuk ka çmim të përcaktuar. Vlerësimi jep shifra të papërfillshme, është 2% që kalon kontrollin e gjithë transakcioneve!

Kontrata kundërshton veten, sepse pretendon që nuk cenohet kontrolli i shoqërisë në një kohë që i ka dhënë 51% privatit. Çdo palë zotohet të mos zbulojë përmbajtjen e marrëveshjes. Asnjë autorizim nga guaska që qeveria ofron!

E para, të kërkojmë me forcë një moratorium, një ndalesë, një ngrirje të të gjitha shoqërive publike me asete, sadopak të jenë asete shtetërore, shoqëri edhe të përbashkëta private, shtetërore.

Numri i tyre nuk mund të rritet dhe duhet të kuptojmë për të gjitha kompanitë e tjera çfarë transakcionesh duan të hyjnë dhe çfarë duan të bëjnë, sepse asnjëri nuk jep garanci që pasi kjo skemë të mbyllet dhe në sektorin e shëndetësisë, mos dalë një skemë tjetër, t'u them unë pyjeve për shembull, që të operohet në të njëjtën mënyrë.

Së dyti, të kërkojmë patjetër me anë të nismave ligjore, garë publike ndërkombëtare për çdo ortak privat. Ne nuk i heqim dot të drejtën shtetit që të hyjë në kompani të përbashkëta me privat, por sigurisht kompania ka një objekt dhe sigurisht për këtë duhet hapur garë ndërkombëtare.

Po pse nuk hapet garë ndërkombëtare rasti i KAYO-s? Se nuk mund të fitonte Roni i vet, i cili nuk ka asgjë në backgroundin e tij, përveçse është mik personal i Edi Ramës. Përndryshe, e njëjta skemë do të ndodhi edhe në sektorin e shëndetësisë. Do të vijë Roni i dytë, kushdo të jetë ai, i treti, i katërti e me radhë ose kushdo të jetë dhe do të bëjë të njëjtën skemë këtu. Miliarda euro do t'ia, miliona, qindra miliona janë tani por me rritjen e buxheteve do kapin këtë dhe askush nuk do marrë vesh ku blihet, çfarë blihet, si shitet, ku shkojnë këto para.

Dhe gjithmonë pyetja është, a mund ta bëjë privati këtë gjënë mirë? Pse nuk e bën tregu konkurrues dhe pse duhet ta bëjë shteti? Kjo është një pyetje tjetër.

Ndalimi i klauzolave të konfidencialitetit në kontratat me kapital publik. S'mund të ketë! Këto janë kontrata për themelimin e shoqërive të përbashkëta dhe nuk mund të ketë klauzola që ndalojnë transparencën. Është në kundërshtim me ligjin, në kundërshtim me ligjin shqiptar, në kundërshtim me standardet e OECD-së, në kundërshtim me çfarë kërkon Bashkimi Evropian dhe FMN-ja.

Dhe rikthimin e pragjeve të VKM-në me nivele të mëparmshme, do t'i ulim pragjet në mënyrë që të bëjnë dhe auditim ligjor këto kompani, jo thjesht auditim ekonomik financiar. Çfarë duhet, më shumë se kaq?

Së pari duhet një politikë kombëtare e pronësisë shtetërore.

Të gjitha vendet e BE-së, edhe vendet që synojnë të këtij rajoni që të hyjnë në Bashkimin Evropian, kanë një politikë kombëtare. Politika kombëtare arsyetohet pse nevojiten kompani publike në sektorët përkatës. Dhe kjo raportohet para parlamentit. Vendimmarrjet politike sigurisht i janë qeverisë, por politikëbërja në konceptin strukturor është e parlamentit. E dyta, ajo që kërkohet prej kohësh në Shqipëri dhe s'është realizuar ndonjëherë, raport agregat vjetor për ndërmarrjet shtetërore. Edhe ky para parlamentit.

Po ne jemi në situatën absurde që nuk arrijmë dot të gjejmë as bilanciç e OSHEE-së për t'u thënë dhe nuk arrijmë dot të kuptojmë se çfarë ndodh me gjigantët, me dinozaurët e korrupsionit të kompanive publike.

Asnjëri nuk gjen dot asnjë informacion çfarë ndodh me Ujësjellës Kanalizimet. Sa punësohen, ku punësohen, për çfarë arsye punësohen, sa arrihen objektivat vjetorë, sa realizohen investimet, kush është kosto efektive e investimeve? Kjo vlen për ujësjellësit, kjo vlen për OSHEE-në, kjo vlen për KESH-in, kjo vlen për OST-në, për të gjithë dinozaurët e mëdhenj të kompanive publike.

E prandaj do të duhet, dhe jemi duke punuar në këtë drejtim, dhe një ligj për qeverisjen e ndërmarrjeve shtetërore. Siç e kërkon OECD-ja, siç shumë vende të rajonit që vijnë nga eksperiencia e ekonomisë së centralizuar dhe kanë trashëguar vende të tilla të ndërmarrjeve shtetërore.

Sllovenia është një rast suksesi, Rumania është një rast tjetër suksesi, Bullgaria është duke bërë përpjekje. E kanë zgjidhur këtë gjë duke çmontuar lidhjen e politikës me kompanitë shtetërore, duke mos lejuar nepotizmin politik dhe nepotizmin ekonomik që të ndërhyjë.

Në rastin e Shqipërisë, çfarë do të thotë kjo? Që gjithë punonjësit e KESH-it, OSHEE-së, OST-së, Ujësjellës Kanalizime, të mos përdoren si patronazhistë dhe numri i tyre të mos rritet me 30-40% sa herë që ka fushata elektorale. Sepse kështu blihen votat me paratë tona. Këtë do të thotë kjo gjë dhe për këtë ligj jemi duke punuar dhe grupi parlamentar unë besoj shumë shpejt do ta paraqesë.

Të fillojmë një debat real publik mbi pasurinë tonë publike. Si duam ta menaxhojmë dhe çfarë niveli transparence do të menaxhojmë.

Dhe e fundit, jo më pak e rëndësishmja, është bërë gjithçka që ky treg apo tregje të caktuara të mos jetë në sytë e publikut, janë mbyllur çdo derë e transparencës. Autoriteti i Konkurrencës ka një detyrë të shtuar për të kontrolluar këto sektorë.

Pyetje: Përshëndetjet zoti Bozdo. Për sa kohë që shteti jep ekskluzivitete të këtyre kompanive, si në rastin e KAYO-s që të jetë furnizuese, a parashikon ligji kufizime që në çdo rast shteti të jetë, po them, maxhoritar në aksione në një kompani që krijon me privatizim? Pra, në rastin konkret ne pamë që shteti ishte vetëm 20% aksioner. A është ligjore kjo dhe a është normale që të ndodhë? Do të keni një nismë për këtë?

Zoti Bozdo, para disa javësh, para se të mbyllej sesioni i kaluar parlamentar, maxhoranca miratoi me urgjencë një marrëveshje kredie me Shtetet e Bashkuara të Amerikës rreth 100 milionë dollarë në fushën e mbrojtjes. A ka rrezik që kjo kredi dhe një pjesë e këtyre parave të përdoren dhe të kalojnë nëpërmjet KAYO-, nëpërmjet kësaj skeme, dhe a keni ju informacion, duke qenë se u miratua me urgjencë në mënyrë që të zbatohet sa më shpejt, që ndoshta një pjesë e këtyre parave apo e blerjeve që Shqipëria ka bërë për armatimet, të kenë kaluar nëpërmjet KAYO-s dhe të kemi abuzime dhe në këtë kredi?

Eno Bozdo: Shikoni, janë dy çështje brenda pyetjes suaj.

E para, sipas praktikës, udhëzuesit të OECD-së, se thashë që Bashkimi Evropian nuk ka direktiva përgjegjëse për këtë gjë, por përdor si bibël të saj udhëzuesin e OECD-së për qeverisjen e mirë të korporatave publike. E para, sa herë që shteti fal ekskluzivitet tregtar apo ekonomik në një sektor, këtë e bën duke e arsyetuar në emër të një interesi më të lartë publik. Sektori i armatimeve mund të jetë fare mirë, sepse për arsye të caktuara, ca të dhëna janë sekrete. Jo çdo gjë që kalon, jo numri i makinave që prodhohet, por pjesë të tjera të informacioneve ushtarake mund të jetë, ndoshta duhet të jetë sekret.

E para, pra arsyetohet pse arrihet këtu.

E dyta, për sa kohë bëhen me fonde publike, se këto janë të gjitha fonde publike që jepen, ç'kuptim ka të dorëzosh ti paketën kontrolluese të privati? Lekët janë tonat, shumicën e mbajmë unë. Privati ftohet të ofrojë vetëm ekspertizën dhe know-how që nuk e ka shteti.

Se ky është thelbi i gjësë. Unë kam paratë, ti më jep know-how se sektori privat ka know-how më të madh sesa sektori publik në situata të caktuara. Dhe këto janë të gjitha të sanksionuara. Këtu kemi kundërshtim me rregullat, me logjikën ekonomike por dhe logjikën e OECD-së, por dhe logjika e modeleve të vendeve të Bashkimit Evropian, nuk kemi mbërritur ndonjëherë në sisteme të tilla që as i gjen, por këto janë sui generis, janë sisteme të veçanta të shpikura për të mbajtur jashtë kontrollit të gjithë financimet publike, që askush mos ketë asnjë të dhënë se çfarë bëhet.

Për pjesën e dytë të pyetjes suaj, kontrata me aq sa unë jam në dijeni, nuk përmban specifikime të këtij lloji, pra nuk thotë detyrimin e palës shqiptare për t'u përdorur në sektorë të caktuar. Kjo mund të jetë fare mirë e pjesë e konfidencialitetit.

Unë në momentin që flasim nuk kam asnjë indicie. Por, duke njohur këtë qeveri dhe të gjitha, duke njohur kryeministrin, nuk do të ishte aspak çudi që një gjë e tillë të ndodhë, vetëm se pastaj Roni i vet duhet të gjejë një marifet tjetër për ta mbajtur të qetë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara dhe për t'i hedhur hi syve amerikanëve, se jam shumë i sigurt që partneri ynë më i madh nuk mund të pranojë të hyjë pjesë e skemave të tilla korruptive, qoftë edhe kur jep një ua tregtare që përdoret një sistemi në sektorin e mbrojtjes.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 11 Shtator13:10

[“Qeveria po tenton të maskojë ligjin 21/2024 me një projektligj për VNM-në”, Ina Zhupa: Është fasadë, ligji 21/2024 duhet shfuqizuar](#)

Kryetarja e Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën, deputetja e PD-së Ina Zhupa, ka kundërshtuar projektligjin e qeverisë eum...

POLITIKE 11 Shtator12:26

[Arben Ahmetaj hodhi akuza për trafik armësh, reagon për herë të parë qeveria Rama](#)

Ka qenë ministria për Shtetin dhe Parlamentin, Erjona Ismaili, ajo që ka reaguar pas mbledhjes së qeverisë lidhur me akuzat e pretend...

POLITIKE 11 Shtator10:30

[Demo emërohet ministër i Brendshëm, Rama: Besfort Lamallari do të jetë pjesë e ekipit tim në Kryeministri!](#)

Kryeministri Edi Rama ka reagu për ndryshimet në qeveri, ku Besfort Lamallari u largua nga ministria e Brendshme, ndërsa do të zëve...

POLITIKE 11 Shtator10:04

[Ndryshime në qeveri/ Rama pritet të shkarkojë sot Besfort Lamallarin, ja kush pritet të zërë vendin e tij](#)

Kryeministri Edi Rama pritet të bëjë sot ndryshime në qeveri. Bëhet me dije se në mbledhjen e qeverisë, të parashikuar p...

POLITIKE 11 Shtator09:19

[25 vite nga sulmi terrorist në SHBA, Begaj: 11 shtatori, kujtesë kolektive që ka riformësuar jetët tona!](#)

Presidenti Bajram Begaj ka përkujtuar 25-vjetorin e sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke ...

POLITIKE 11 Shtator08:39

[SPAK i zbuloi dy vila luksoze, si justifikohet Balluku kur nisi hetimi: Nuk kam as 300 as 3 apartamente!](#)

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) i ka sekuestruar dy vila luksoze në jug të vendit ish z&eu...

POLITIKE 11 Shtator07:40

[104 protesta, sot protestuesit do të 'zbresin' sërish para Kryeministrit: Rama jep dorëheqjen!](#)

Këtë të premte, qytetarët do të mbledhen sërish në sheshin përpara Kryeministrit, ndërsa shënojnë...

POLITIKE 10 Shtator 23:41

[Rikthimi i protestave të opozitës, Berisha tregon skenarët](#)

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha në një intervistë për gazetarin Çim Peka ka folur dhe për planet e opozitës p...

POLITIKE 10 Shtator 22:24

[Adriatik Lapaj e thotë hapur: Për Tiranën do të mbështesim Florjan Binajn](#)

Adriatik Lapaj deklaroi se lëvizja "Shqipëria Bëhet" vazhdon të mbështesë Florjan Binajn si kandidat për Tiranë...

POLITIKE 10 Shtator 22:09

["Kanë dalë email-et me arkitektin për vilën në Palasë"/ Shehaj përplasjet me Rexhaj për dosjen e Ballukut](#)

SPAK ka rënduar akuzat për Belinda Ballukun pas hetimeve të tjera që janë kryer nga prokurori Dritan Prençi. Ndaj ish-zv.kryemin...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 10 Shtator

[VIDEO/ Momenti kur policët e armatosur "deri në...](#)

Policia ka shkatërruar një organizatë kriminale që kishte kryer dhjetëra vjedhje dhe mashtrime në Atikë dhe në rajone t&...

SHOWBIZ 10 Shtator

["Jam princesha jote e vogël, të dua"/ I dërgont...](#)

Një oficer burgu në Britani ka shmangur dënimin me burg pasi u përfshi në një lidhje tre-mujore me një të burgosur, t&e...

AKTUALITET 10 Shtator

[EMRI/ Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinë...](#)


Përgjegjësia e Cristiano Mossalit për vrasjen e shqiptarit Nexhat Ramës konsiderohet e sigurt, ndërsa ajo që mbetet për t&rsq...


INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.